



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
12.12.2020

NJOFTIM

Nr. Protokolli

2301

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Rregullatorit,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të paragrafit 1 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se është përgatitur projektvendimi "Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

Bazuar në shkronjën "c", paragrafi 2, të nenit 20 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator, për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektakti.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe të relacionit shoqërues.

Materialet e mbledhjes ju vihen në dispozicion nga sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund t'i gjeni në faqen e KQZ-së në internet www.cec.org.al në rubrikën e Njoftimeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

